



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 61 datë 10.06.2026



**"PËR MIRATIMIN E FORMËS SË ORGANIZIMIT TË AKTIVITETIT
FUTBOLLISTIK NËPËRMJET OJF-SË 'KLUBI I FUTBOLLIT PËRMET' DHE
MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT DHE MENAXHIMIT TË TË
ARDHURAVE".**

Në mbështetje të neneve 54 dhe 55 të Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, nenit 304 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 125/2020 "Për Sportin", të ndryshuar, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Përmet nr. 88, datë 05.11.2024 "Për themelimin e Shoqatës Klubi i Futbollit Përmet", Vendimit të Këshillit Bashkiak Përmet nr. 52, datë 02.06.2025 "Për miratimin e Statutit dhe Aktit të Themelimit të Shoqatës Klubi i Futbollit Përmet", Vendimit nr. 7707, datë 05.03.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për regjistrimin e OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet", si dhe pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Përmet, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë organizimin dhe zhvillimin e aktivitetit futbollistik në territorin e Bashkisë Përmet nëpërmjet organizatës jofitimprurëse "Klubi i Futbollit Përmet", të themeluar nga Bashkia Përmet dhe të regjistruar sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të miratojë formën e bashkëpunimit institucional ndërmjet Bashkisë Përmet dhe OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet", me qëllim zhvillimin, administrimin dhe promovimin e aktivitetit futbollistik në territorin e Bashkisë Përmet.
3. Të miratojë Marrëveshjen e Bashkëpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave ndërmjet Bashkisë Përmet dhe OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet", sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Të autorizojë Kryetaren e Bashkisë Përmet për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit dhe të çdo akti tjetër administrativ të nevojshëm për zbatimin e saj.



5. Financimi i OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet" të realizohet në përputhje me fondet e miratuara në buxhetin e Bashkisë Përmet dhe sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Bashkëpunimit.

6. OJF-ja "Klubi i Futbollit Përmet" është e detyruar të përdorë fondet vetëm për realizimin e objektivave sportive, të mbajë evidencë të plotë financiare dhe të raportojë periodikisht pranë Bashkisë Përmet mbi përdorimin e fondeve dhe realizimin e aktiviteteve sportive.

7. Ngarkohen Drejtoria e Financës, Sektori Juridik dhe strukturat e tjera përgjegjëse të Bashkisë Përmet për zbatimin e këtij vendimi.

8. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Aleks TANE



KRYETAR
Enila DHIMITRI





**REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA PËRMET**

Nr. ____ prot

Përmet, më ____ . ____ .2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI DHE MENAXHIMI TË TË ARDHURAVE

Në Përmet, sot, më datë ____ . ____ . ____ lidhet kjo kontratë mes palëve:

Bashkia Përmet person juridik me NIPT K49719214P me adresë Sheshi "Abdyl Frashëri" përfaqësuar nga Kryetare e Bashkisë Zj. Alma HOXHA

dhe

Organizata Jo-Fitimprurëse "Klubi i Futbollit Përmet", e regjistruar sipas legjislacionit në fuqi, me seli në stadiumin "Durim Qypi", Përmet, përfaqësuar nga Zj. Shpresa Petro, në vijim "OJF".

NENI 1

Baza Ligjore

Kjo kontratë hartohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 139/2015 'Për Vetëqeverisjen Vendore', i ndryshuar, Ligjin nr. 8788/2001 'Për Organizatat Jo-Fitimprurëse', i ndryshuar, Ligjin nr. 9936/2008 'Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor', Ligjin nr. 10296/2010 'Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin', Ligjin nr. 125/2020 'Për Sportin', i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak Përmet nr. 88, datë 05.11.2024 "Për themelimin e Shoqatës Klubi i Futbollit Përmet", Vendimit të Këshillit Bashkiak Përmet nr. 52, datë 02.06.2025 "Për miratimin e Statutit dhe Aktit të Themelimit të Shoqatës Klubi i Futbollit Përmet", Vendimit nr. 7707, datë 05.03.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për regjistrimin e OJF-së "Klubi i Futbollit Përmet", si dhe dispozitat përkatëse të Kodit Civil.

NENI 2

Objekti i Kontratës

Kjo kontratë ka për objekt rregullimin e marrëdhënies ndërmjet Bashkisë dhe OJF-së për menaxhimin, administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të transferuara nga Bashkia tek OJF.

NENI 3

Qëllimi

Kjo kontratë ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Përmet dhe Shoqatës, të sigurojë përdorimin transparent, efikas dhe në përputhje me ligjin të fondeve publike për arritjen e objektivave të përcaktuara.



Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Bashkisë

miraton kalendarin e aktiviteteve.

Bashkia Përmet ka të drejtën për të mos e kaluar fondin në dispozicion nëse nuk janë përmbushur indikatorët e përcaktuar në kontratë.

Siguron kushtet e përshtatshme mjedisore për zhvillimin e aktiviteteve.

Në rastet e forcës madhore, Bashkia mund të kërkojë në çdo kohë rishikimin ose pezullimin e aktiviteteve të projektit.

Transferojë fondet sipas afateve të përcaktuara;

Monitorojë zbatimin e projektit;

Ofron mbështetje institucionale sipas nevojës.

NENI 5

Detyrimet e OJF-së

OJF angazhohet të:

- Menaxhojë fondet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë kontratë;
- Përdorë fondet vetëm për qëllimin e përcaktuar;
- Mbajë evidencë të detajuar financiare dhe dokumentacion mbështetës;
- Raportojë periodikisht tek Bashkia mbi përdorimin e fondeve sipas kërkesës së grupit të monitorimit.
- Lejojë monitorim dhe kontroll nga Bashkia.
- Të mos shpërndajë fitime apo të ardhura për anëtarët.

Neni 6

Vlefë e Kontratës

Kontrata lidhet për vlerën 2,000,000 lekë.

Financimi realizohet nga Buxheti 2026 i Bashkisë Përmet.

Vlera financiare e kontratës duhet të depozitohet në llogarinë bankare të shoqates, detajet e të cilës janë si më poshtë:

Emri i bankës: Tirana Bank

IBAN: AL80 2061 1097 0000 1903 2820 D100 ALL

8.4 Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Përmet do të kryejë likuidimin e vlerës totale në dy transhe:



Transhi i parë (60% e vlerës totale) 1 200 000 lekë,
Transhi i dytë (40% e vlerës totale) 800 000 lekë,

Lëvrimi i transhit të parë do të bëhet pas nëshkrimit të kontratës. Pasi subjekti fitues, ka shpenzuar të paktën 80% të vlerës së transhit të parë dhe ka realizuar të paktën 80% të indikatorëve të performancës për periudhën e raportimit, ai ka të drejtë të dorëzojë një raport financiar dhe një raport përshkrues, si dhe një kërkesë për disbursimin e transhit të dytë. Lëvrimi i transhit të dytë do të bëhet pasi raportet të jenë certifikuar nga Bashkia.

NENI 7 **Menaxhimi Financiar**

Të gjitha fondet do të administrohen në një llogari bankare të dedikuar në emër të OJF-së. Çdo shpenzim duhet të jetë i dokumentuar dhe i justifikuar.

NENI 8 **Përdorimi i Fondeve**

Fondet do të përdoren vetëm për:

- paga për Drejtorin Ekzekutiv
- pagesë për personat e angazhuar Trajner/Financier
- transport dhe akomodim për ndeshje;
- pajisje sportive dhe uniforma;
- organizim ndeshjesh dhe aktivitete;
- shpenzime operative të klubit.

Neni 9 **Ndalimi i Nënkontraktimit**

Subjekti fitues për zbatimin e projektit për të cilën është shpallur fitues nuk i lejohe të lidhë marrëdhënie nënkontraktuale me një subjekt të tretë.

NENI 10 **Raportimi dhe Transparenca**

OJF duhet të paraqesë raporte financiare dhe narrative, të cilat përfshijnë:

- Pasqyrë të të ardhurave dhe shpenzimeve;
- Progresin e aktivitetit;
- Problematikat e hasura dhe rekomandimet.

NENI 11 **Kontrolli dhe Monitorimi**

Bashkia ka të drejtë të kryejë kontrolle dhe monitorim në çdo kohë. OJF është e detyruar të bashkëpunojë plotësisht.

Neni 12

Prona Intelektuale

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Subjekti fitues gjatë kontratës do ti përkasin Bashkisë, i cili mund ti përdorë ato sipas gjykimit të tij.

Neni 13

Gjuha e Kontratës

Gjuha e kontratës është gjuha shqipe.

Neni 14

Vendndodhja

Aktivitetet duhet të zbatohen ekskluzivisht në territorin e Bashkisë Përmet.

NENI 15

Zgjidhja e Kontratës

Kontrata mund të zgjidhet:

- Me marrëveshje të ndërsjellë;
- Në rast shkeljeje të rëndë nga njëra palë;
- Në rast të përdorimit të fondeve në kundërshtim me qëllimin.

Kontrata zgjidhet automatikisht nëse:

- Konstatohet mashtrim financiar;
- Refuzohet kontrolli ose auditimi;
- Përdoren fondet për qëllime personale

NENI 16

Penalitetet

Në rast shkeljeje, pala përgjegjëse do të mbajë përgjegjësi ligjore dhe financiare sipas legjislacionit në fuqi.

Në rast abuzimi ose përdorimi të padrejtë, OJF-ja detyrohet të kthejë fondet e përfituara.

Bashkia ka të drejtë të:

- Ndalojë menjëherë disbursimin e kësteve të ardhshme;
- Bllokojë fondet e mbetura deri në përfundim të verifikimit.

Neni 17
Njoftimet e Palëve

Çdo komunikim midis palëve do të bëhet me shkrim. Njoftimi i palëve do të bëhet me shkrim brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e faktit dhe problemeve që mund të lindin gjatë ekzekutimit të kontratës.

Njoftimet duhet të përmbajnë, por nuk kufizohen, tek të dhënat si më poshtë:

- detajet e duhura në lidhje me shkakun e mospërbushjes dhe të zgjidhjes;
- afatin për korrigjimin e ngjarjes së mospërbushjes si dhe veprimet/masat, që pasojnë mosrespektimin e afatit, sipas përcaktimeve në këtë kontratë;
- çdo informacion tjetër të rëndësishëm.

Adresat dhe numrat e kontaktit, që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Kontrate, janë:

Për Bashkinë

Alma Hoxha, Kryetar i Bashkisë:

Adresa: Sheshi "Abdyl Frashëri", Përmet

E – mail: info@bashkiapermet.gov.al

Për OJF-në

Shpresa Petro- Kryetar i Shoqatës " Klubi i Futbollit Përmet"

Adresa:Pranë stadiumit "Durim Qypi" Përmet

E-mail: shspermeti89@gmail.com

Neni 18
Dispozita të fundit

Çdo ndryshim i kësaj kontrate bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga të dyja palët.

Për mosmarrëveshjet e ndryshme që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj akt-marreveshjeje, palët bien dakort t'i zgjidhin ato me mirekuptim, ose në rast të kundët në Gjykatën kompetente.

BASHKIA PËRMET
KRYETAR I BASHKISË
ALMA HOXHA

OJF "KLUBI I FUTBOLLIT PËRMET"
SHPRESA PETRO